UDHËZIM
Nr.17/3, datë 13.11.2008

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të neneve 35 e 58 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", në pikën 9.4 "Furnizimi i karburanteve", bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas germës b) "Detyrime të palëve", shtohen germat c, ç, d dhe dh, me përmbajtje si më poshtë:

"c) Furnizimi i karburantit ndërmjet shoqërive të tregtimit me shumicë (shoqërive anonime), kryhet vetëm në rastin kur janë importuese dhe kanë magazina doganore, shesin me njëra-tjetrën karburant vetëm në regjimin tranzit, konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës dhe vlera e tatueshme e tij përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

Ky rast aplikohet edhe në rastin kur një prodhues vendas furnizon një shoqëri të tregtimit me shumicë.

ç) Kur karburanti i furnizuar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë është i destinuar të konsumohet për veprimtarinë ekonomike të konsumatorëve të mëdhenj, për nevoja të institucioneve apo enteve publike, si dhe për eksport, vlera e tatueshme e furnizimit përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

d) Kur karburanti furnizohet me tollona, në momentin e dorëzimit të tollonave, apo nëse më parë është bërë ndonjë pagesë, shoqëria furnizuese lëshon faturë tatimore për përfituesin e tollonave dhe lëshimi i faturës, përbën momentin e furnizimit.

Vlera e tatueshme e furnizimit përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

Stacionet e shitjes me pakicë, në fund të muajit regjistrojnë shitjet me tollona në mënyrë që të evidentohen qartë sasitë e shitura për llogari të secilës shoqëri lëshuese të tollonave. Shumat e tollonave hidhen në fund të muajit në një faturë tatimore përmbledhëse, e cila paraqitet në librin e shitjes, por pa efekte (pasi deklarimi është bërë më parë në momentin e dorëzimit të tollonave), pra ato deklarohen me storno.

Si provë e këtij furnizimi shërben kontrata e lidhur midis shoqërisë furnizuese me tollona dhe klientit në të cilën përveç të tjerash, paraqitet dhe sasia dhe çmimi i karburantit të furnizuar.

dh) Klientëve, persona të tatueshëm, të furnizuar nga shoqëritë e shitjes me pakicë, apo ato të shitjes me shumicë të karburanteve, u lind e drejta e kreditimit të TVSH-së të paraqitur në faturat tatimore të lëshuara prej këtyre furnizuesve, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

e) Në të njëjtën zonë, kryesori nuk mund të faturojë tek pikat e treta çmime më të ulëta se çmimi i akorduar pikave të shitjes nën pronësinë e tij.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Financave
Ridvan Bode